



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË  
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. 609 Prot.

Tiranë, më 23 . 04 .2020

URDHËR

Nr. 14 , datë 23 . 04 .2020

“PËR  
FILLIMIN E PROCEDURËS SË PËRZGJEDHJES SË  
KANDIDATËVE JOMAGJISTRATË PËR POZICIONIN E INSPEKTORIT PRANË  
ZYRËS SË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË”

Në mbështetje të nenit 204, pika 1, shkronja “c” dhe “k”, të nenit 211, pika 2, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, Vendimit Nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësisimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit”, Urdhrit Nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për miratimin e Rregullores “Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë””,

KONSTATOVA SE:

Inspektori i Lartë i Drejtësisë në mbështetje të nenit 283, pika 2, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar dhe Urdhrit Nr. 1, datë 07.02.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për miratimin e strukturës dhe organikës së përkohshme të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, ka shpallur hapjen e procedurës së aplikimeve me qëllim plotësimin e pozicioneve vakante për 6 (gjashtë) inspektor jomagjistratë pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka ftuar çdo person të interesuar, që plotëson kushtet dhe kriteret e parashikuara në nenin 209, pika 6, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, të marrë pjesë në këtë procedurë përzgjedhëse dhe të paraqesë pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë shprehjen e interesit për të kandiduar. Kërkesa, duhet të dorëzohet brenda datës 2.03.2020 pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, me adresë: Bulevardi “Zogu I”, Tiranë, Shqipëri.

Kandidatët të cilët kanë shprehur interesin, do t'i nënshtrohen procedurës së përzgjedhjes në përputhje me parashikimet e nenit 209, pika 6, të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar; Vendimit Nr. 536, datë 25.7.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimin të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës dhe të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit", si dhe Urdhrit Nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, "Për miratimin e Rregullores "Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë",

Për këtë arsye,

### URDHËROJ:

1. Fillimin e procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve jomagjistratë për 6 (gjashtë) pozicione inspektor pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;

2. Ngritjen e Komitetit të Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve, për zhvillimin e kësaj procedure përzgjedhëse me përbërje si më poshtë vijon:

- a) Artur Metani Kryetar;
- b) Marsela Pepi Anëtare;
- c) Mirela Kapo Anëtare.

3. Publikimin në faqen elektronike të Zyrës së Inspektorit të Lartë [www.ild.al](http://www.ild.al), në rubrikën "Njoftime", seksioni "Rekrutimi i inspektorëve jomagjistratë", të listës së kandidatëve të cilët kanë shprehur interes, si dhe njoftimin për fillimin e procedurës së përzgjedhjes së tyre;

4. Ngarkohet personeli i Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë të ndjekë procedurat përkatëse, si dhe të përgatisë aktet e nevojshme për zhvillimin e kësaj procedure përzgjedhëse, sipas udhëzimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;

5. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin dhe njoftimin e këtij Urdhri.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

### INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

ARTUR METANI

